



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, më datë 03 Nëntor 2016, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Z. Gentian	Sala	Kryetar
Z. Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Z.Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Z.Gledis	GJIPALI	Anëtar
Z.Piro	MISHA	Anëtar
Znj.Suela	MUSTA	Anëtar
Z.Zylyftar	BREGU	Anëtar

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës, miratoi vendimet e mëposhtme:

1. Zbatimi i vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë për dhënien në shfrytëzim të rrjeteve të plota numerike për shoqëri "Klan" sh.a dhe "Top Channel" sh.a dhe miratimi i kërkesës së shoqërisë "Klan" sh.a **(Vendim nr. 230, datë 03.11.2016)**
2. Miratimi i vendimit për çeljen e garës për licencimin e rrjeteve kombëtare dhe dokumentacion i aplikimit **(Vendim nr. 231, datë 03.11.2016)**
3. Miratimi i ndryshimit dhe amendimi i "Rregullores për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio" **(Vendim nr. 232, datë 03.11.2016)**
4. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë "B.B.F" sh.a., licencuar për subjektin audioviziv privat vendor "Tv BBF" për heqjen e detyrimeve financiare për periudhën e pezullimit të shqyrtimit të kërkesës për rinovimin e licencës **(Vendim nr. 233, datë 03.11.2016)**
5. Zëvendësimin e licencës të shoqërisë "UTV Education" sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv privat vendor "UTV Education", me licencë për transmetime audiovizive dhe rinovimin e licencës për transmetime audiovizive me afat deri në datën e mbylljes së transmetimeve analoge, në zonën e licencimit të subjektit audioviziv privat vendor "UTV Education", me kushte teknike të njëjta me kushtet e licencës ekzistuese **(Vendim nr. 239, datë 03.11.2016)**.
6. Zgjerimi i zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë "Vani" sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Mati", në "Njësinë Administrative Klos" **(Vendim nr. 240, datë 03.11.2016)**.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

7. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Hajri Hoxha, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “HB-CA TV” (**Vendim nr. 241, datë 03.11.2016**).
8. Mosrinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Dritan Xhaçi, licencuar me vendimin nr. 21, datë 28.07.2010 të KKRT-së, (sot AMA) për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV kabllor Xhaçi” (**Vendim nr. 234, datë 03.11.2016**).
9. Refuzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të **vendimit nr. 33, datë 15.09.2016** të vendosur nga grupi i inspektorëve, në masën 2,000,000 (dy milionë) lekë, ndaj shoqërisë “Arlibon” sh.p.k., për subjektin OSHMA “**Tv Kabllor Fieri**” (**Vendim nr. 235, datë 03.11.2016**).
10. Shfuqizimin e **vendimit nr. 35, datë 22.09.2016** për dënimin me gjobë të vendosur nga grupi i inspektorëve, në masën 2,000,000 (dy milion) lekë, ndaj subjektit person fizik privat z. Dritan Xhaçi, për subjektin OSHMA “**Tv me kabëll Xhaçi**” (**Vendim nr. 236, datë 03.11.2016**).
11. Shfuqizimin e **vendimit nr. 36, datë 22.09.2016** për dënimin me gjobë të vendosur nga grupi i inspektorëve, në masën 2,000,000 (dy milion) lekë, ndaj subjektit person fizik privat z. Dritan Xhaçi, për subjektin OSHMA “**Tv me kabëll Xhaçi**” (**Vendim nr. 237, datë 03.11.2016**).
12. Shfuqizimin e **vendimit nr. 37, datë 23.09.2016** për dënimin me gjobë të vendosur nga grupi i inspektimit në masën 2,000,000 (dy milionë) lekë ndaj shoqërisë “Tring TV” sh.a., për platformën numerike satelitore “**Tring TV**” (**Vendim nr. 238, datë 03.11.2016**).
13. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit person fizik Sulejman Leshi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV kabllor Lushnja”, për shkak të përfundimit të afatit të vlefshmërisë dhe me kërkesën e vetë subjektit për heqje dorë nga autorizimi (**Vendim nr. 242, datë 03.11.2016**).

Tiranë, 04 Nëntor 2016

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE